



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 302, datë 05.06.2023**

**PËR  
NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VERIFIKIMIN E KUSHTEVE  
DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PLOTËSOJË MAGJISTRATI  
(GJYQAR) PËR TË PËRFITUAR KREDI PËR BANIM, SI DHE MIRATIMIN E  
LISTËS SË MAGJISTRATËVE (GJYQARË) PËRFITUES NGA SKEMA E  
SUBVENCIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDISË**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 18.01.2024)*

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 17, të ndryshuar, VKM nr. 22, datë 15.01.2020 “Për miratimin e procedurës së detajuar, të kriterëve dhe të kushteve që magjistrati duhet të përmbushë për përfitimin e kredisë për qëllime banimi, interesat e së cilës financohen nga shteti”, Marrëveshjes dypalëshe nr. 8481/3, datë 01.8.2022 dhe nr. 1680/4, datë 11.8.2022, “Për kreditimin në kuadër të programit të subvencionimit të interesave të kredisë për magjistratin”, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe OTP bank, Marrëveshjes dypalëshe nr.174, datë 15.5.2023 dhe nr. 2905, datë 16.5.2023, “Për zbatimin e Marrëveshjes Kuadër mes Bankës OTP Albania Sh.a. dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Përfitimin e Kredisë për Qëllime Banimi nga Magjistratët”, midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe OTP bank, si dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**V E N D O S I:**

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, i përbërë nga dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, si më poshtë:

1. Znj. Fatmira Luli, anëtare e KLGJ,
2. Z. Alban Toro, anëtar i KLGJ,

3. **Z. Ridvan Hado**<sup>1</sup>, anëtar i KLGJ,

Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë:

1. Znj. Irena Plaku – anëtare e KLGJ;
  2. Z. Ilir Rusi – anëtar i KLGJ.
2. Komisioni ka për detyrë, verifikimin e kushteve që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, dhe dokumentacionin së bashku me kërkesën, e paraqitur pranë KLGJ, nga magjistratët (gjyqtarë) dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë.
  3. Komisioni, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij mbështetet nga nëpunësit e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.
  4. Në përfundim të procesit të verifikimit, Komisioni nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, dërgon pranë bankës, listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues.
  5. Komisioni, do ta ushtrojë veprimtarinë e tij, për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri në datë **31.12.2024**<sup>2</sup>.
  6. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 18.01.2024.

<sup>2</sup> Ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 18.01.2024.